

Vendim nr. 101 datë 15.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 15.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (H) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **HARIS RAHOVA, ISMET RAHOVA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 466, datë 13.12.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-2874, datë 02.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 124, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Ismet Rahova dhe Haris Rahova (babë e bir), së bashku me shtetasen V.R. (bashkëshortja e kërkuesit Ismet Rahova dhe nëna e kërkuesit Haris Rahova), në datën 01.04.2020, bazuar në ligjin nr. 10079, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar (*ligji nr. 10079/2009*), kanë paraqitur padi kundër Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS) dhe shoqërisë “Sigal Unica Group Austria” sh.a. (*shoqëria e sigurimit*), me objekt shpërblimin e plotë të dëmit të pësuar, në masën 6.174.298 lekë, përfshirë kamatëvonesat që nga data e paraqitjes së padisë deri në datën e ekzekutimit të vendimit, si dhe ekzekutimin e përkohshëm të vendimit, sipas neni 317 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), për shkak se në datën 07.03.2019 kërkuesi Haris Rahova ka mbetur i dëmtuar si pasojë e një aksidenti automobilistik të ndodhur në Shkodër me një automjet të pasiguruar.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1015 (5181), datë 07.12.2020, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin solidarisht të të paditurve të paguajnë dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën prej 5.719.888 lekësh, si dhe kamatat ligjore. Në vijim, në zbatim të nenit 317 të KPC-së, ajo gjykatë ka vendosur ekzekutimin e përkohshëm, për atë pjesë të dispozitivit që, sipas nenit 511 të KPC-së, nuk lëshohet urdhri i ekzekutimit, pasi është drejtpërdrejt i zbatueshëm nga shërbimi përmbarrimor. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në rastin e kërkuesve gjen zbatim neni 317 i KPC-së, pasi shpërblimi për dëmin pasuror konsiston në rimbursimin e të ardhurave që kërkuesi Haris Rahova do të kishte realizuar nga puna, të cilat, për shkak të invaliditetit të përhershëm të tij, mund t’i mungojnë në të ardhmen, ndërsa shpenzimet e kryera për kurim përfshijnë nevojën për kurim dhe për ushqim.

3. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim shoqëria e sigurimit dhe BSHS-ja, respektivisht në datat 08.02.2021 dhe 09.02.2021, ndërsa kërkuesit dhe shtetasja V.R. kanë paraqitur kundërankim në datën 24.02.2021. Mbi bazën e tyre, Gjykata e Apelit Shkodër ka regjistruar çështjen civile me nr. 1362, datë 09.05.2022, e cila nuk është shqyrtuar ende.

4. Po kështu, në datën 17.12.2020 shoqëria e sigurimit ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, duke kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pasi, sipas saj, në rastin konkret paditësit nuk gjenden në asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 317 të KPC-së, të cilat janë të natyrës emergjente dhe të përkohshme, pasi lidhen me detyrimin për ushqim, shpërblimin nga puna, rivendosjen në posedim të banesës bashkëshortore, si dhe me rrezikun e pësimit të dëmeve të rëndësishme, që nuk mund të riparohen ose që mund ta vështirësojnë së tepërmi, deri në pamundësi, ekzekutimin e vendimit. Kundër këtij

ankimi të veçantë, në datën 26.01.2021, kanë paraqitur kundër-ankim të veçantë kërkuesit dhe shtetasja V.R., me pretendimin se dëmtimet e pësuar jo vetëm nuk janë riparuar, por janë rënduar dhe nëse vendimi nuk jepet me ekzekutim të përkohshëm, rrezikohet që ato dëmtime të mos riparohen më.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 466, datë 13.12.2021, në dhomën e këshillimit, ka vendosur pranimin e ankimit të veçantë, duke rrëzuar kërkimin për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi nuk ka paraqitur rrethana dhe prova për të vërtetuar rastet e parashikuara në nenin 317 të KPC-së. Po kështu, sipas saj, nuk rezulton që nga vonesa e ekzekutimit të vendimit mund të rezultojë ndonjë dëm, i cili nuk mund të riparohet, duke vlerësuar se dëmshpërblimi është i garantuar nga fondi i kompensimit të BSHS-së, ndërsa vendimi nuk është shoqëruar as me një garanci pasurore. Në paragrafin e fundit të dispozitivit të vendimit, gjykata e apelit është shprehur: *“Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afatit ligjor që është 30 ditë nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.”*.

6. Mbi bazën e rekursit të ushtruar nga kërkuesit dhe shtetasja V.R., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2874, datë 02.11.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, pasi ka vlerësuar se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor 5-ditor, sipas neneve 318, 443, paragrafi i katërt dhe 470, pika 2, të KPC-së (të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.03.2021). Sipas Gjykatës së Lartë, avokati i kërkuesve ka marrë njoftim për vendimin e arsyetuar në datën 11.05.2022, ndërsa rekursi i veçantë është dorëzuar në datën 10.06.2022, pra jashtë afatit ligjor 5-ditor. Shënimi në vendimin e gjykatës së apelit se kundër vendimit lejohet rekurs brenda 30 ditëve, nuk legjitimon paraqitjen e rekursit tej afatit 5-ditor të përcaktuar në ligj. Afatet e rekursit janë ato të përcaktuara në ligj dhe, si të tilla, konsiderohen të njohura dhe me fuqi detyruese për zbatim si për gjykatën, ashtu edhe për palët.

7. Në datën 02.03.2023 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2874, datë 02.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesve

8. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

- 8.1. *E drejta e aksesit në gjykatë*, pasi ajo gjykatë nuk ka vlerësuar praktikën e konsoliduar të gjykatës së apelit në lidhje me dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, të cilat, në rastet e ndryshimit të vendimit të shkallës së parë, kanë parashikuar të drejtën për kundërshtimin e vendimit të tyre me rekurs brenda 30 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij. Gjykata e apelit nuk ka bërë dallimin mes rekursit të zakonshëm dhe rekursit të veçantë, në mënyrë që të ushtrohej mjeti efektiv brenda afatit. Nga ana tjetër, vendimi i gjykatës së apelit për ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, për sa i përket ekzekutimit të përkohshëm, është përfundimtar dhe mosparashikimi i saktë për afatin brenda të cilit duhej ushtruar rekursi, ka cenuar edhe të drejtën për ekzekutimin e tij.
- 8.2. *E drejta për një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi ajo gjykatë duhej të kishte njësuar praktikën në rrethanat kur ka qëndrime të ndryshme nga Gjykata e Apelit Shkodër, për sa u përket vendimeve të saj, në të cilat ka parashikuar të drejtën e kundërshtimit me rekurs brenda afatit 30-ditor, në rastet e ndryshimit të vendimeve për ekzekutim të përkohshëm.
- 8.3. *E drejta për zgjidhje efektive*, pasi kërkuesit, ndonëse kanë shteruar të gjitha shkallët e gjyqësorit, nuk kanë arritur të gjejnë një zgjidhje efektive për çështjen e tyre.
- 8.4. *Siguria juridike në drejtim të të drejtave të fituara*, pasi ajo gjykatë i ka vendosur kërkuesit në një pozitë potencialisht të vështirë, duke cenuar të drejtën e tyre për të përfitur nga ekzekutimi i përkohshëm i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pasur parasysh se, në disa raste, vendimet e formës së prerë nuk janë ekzekutuar ende, ndonëse ka kaluar një kohë realisht e gjatë.
- 8.5. *E drejta për ekzekutimin e vendimeve*, pasi gjykata e shkallës së parë e ka dhënë vendimin me ekzekutim të përkohshëm bazuar në nenin 317, paragrafi i fundit, të KPC-së, që i njeh asaj diskrecion, për sa i përket vlerësimit të rrezikut potencial të përkeqësimit të situatës së palës së dëmtuar. Gjykata e apelit nuk e ka vlerësuar faktin se çështja do të qëndrojë gjatë në atë gjykatë për t'u shqyrtuar në themel dhe, po kështu, as rrezikun për të mos realizuar të drejtat e fituara nga mosekzekutimi i vendimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuësve

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kolegji vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

13. Rregulli i shterimit të mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës është plotësuese e gjykimit në gjykatat e zakonshme për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (*parimi i*

subsidiaritetit). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka disponuar për themelin e çështjes, duke detyruar palët e paditura për të dëshmipërblyer kërkuessit dhe shtetasen V.R. në shumat përkatëse dhe, për ato shuma, ka pranuar kërkimin tyre për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, bazuar në nenin 317 të KPC-së. Për sa i përket disponimit të saj për themelin e çështjes të dyja palët e paditura kanë paraqitur ankimet respektive në gjykatën e apelit, ndërsa kërkuessit dhe shtetasja V.R. kanë paraqitur kundërankim, për të cilat ajo gjykatë nuk është shprehur ende me një vendim. Nga ana tjetër, bazuar në ankimin e veçantë të shoqërisë së sigurimit dhe kundërankimit të veçantë të kërkuessve dhe shtetasës V.R., gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kërimit për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë të kërkuessve dhe shtetasës V.R., pasi ka vlerësuar se është paraqitur jashtë afatit ligjor 5-ditor për ushtrimin e rekursit të veçantë.

15. Gjithashtu, Kolegji konstaton se objekti i ankimit kushtetues individual i kërkuessve lidhet me procedurën gjyqësore për shqyrtimin e rekursit të veçantë nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafët 6 dhe 11 të këtij vendimi*), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit, së drejtës për një gjykatë të caktuar me ligj, së drejtës për zgjidhje efektive, sigurisë juridike në drejtim të të drejtave të fituara, si dhe së drejtës për ekzekutimin e vendimeve. Në këtë situatë, për të vlerësuar përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, merr rëndësi të përcaktohet nëse vendimi i kundërshtuar nga kërkuessit

në ankimin e tyre ka formë përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se, si rregull, individ mund t’i drejtohet asaj për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare mbi të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Referuar përmbajtjes së neneve 318 dhe 319 të KPC-së, Kolegji evidenton se vendimet për ekzekutim të përkohshëm të dhëna sipas nenit 317 të po këtij Kodi nuk konsiderohen përfundimtare për efekt të gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi përmes tyre nuk vendoset automatikisht dhe në mënyrë përfundimtare në lidhje me të drejta ose detyrime civile. Ato janë, gjithashtu, vendime me natyrë të përkohshme, për të cilat Gjykata është shprehur se merren gjatë procedurës së themelit të çështjes dhe nuk konsiderohen si një procedurë e veçantë, e ndarë nga ajo kryesore (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin nr. 00-2022-2874, datë 02.11.2022, ka vlerësuar vetëm kriteret për paraqitjen e rekursit të veçantë, duke arsyetuar se cilësia e “veçantë” e ankimit ose e rekursit [...] i dallojnë ato nga mjetet ligjore të ankimit ndaj vendimeve përfundimtare. Ajo gjykatë nuk ka shqyrtuar në themel padinë e kërkuarve për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, pasi çështja është ende në pritje për t’u shqyrtuar nga gjykata e apelit. Për rrjedhojë, gjykimi i çështjes ku marrin pjesë kërkuarët është ende në proces dhe i papërfunduar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë që kundërshtohet nuk e ka përmbyllur atë.

19. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuarët nuk plotësojnë kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion në kërkesën e tyre drejtuar Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

20. Në përfundim të analizës për kriteret paraprake, Kolegji vlerëson se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.